



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA			
Sh.	12	Nr.	14690
U.		Br.	
Nr. i faq.	2	Data:	13/06
Br. str.		Datumi:	2025
KAMENICË/A			

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë

Dt.13.06.2025

Bazuar në nenin 14 paragrafi 14.1, 14.2 dhe 14.3 si dhe nenit 17 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë në Komunën e Kamenicës, nxjerr këtë:

THIRRJE

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TEZGAVE PËR PLASIMIN E PRODHIMEVE VENDORE

Bazuar në nevojat e prodhuesve vendor të Komunës së Kamenicës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, i fton të gjithë prodhuesit vendor të cilët janë të interesuar të i plasojnë prodhimet e veta, mund të aplikojnë për shfrytëzimin e tezgave të cilat jepen në shërbim nga Komuna. Ju njoftojmë se tezgat janë me dimensione 2.30m lartësi me 1.90m gjatësi dhe 1.10m gjerësi të cilat do të përdoren për shitjen e disa prodhimeve vendore dhe mund të përdoren vetëm brenda territorit të Komunës së Kamenicës. Caktimi i vendit për vendosjen e tezgës duhet të bëhet në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, në bazë të rregulloreve Komunale në fuqi.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Kërkesa për aplikim , (merret në QSHQ, kati i I (parë)- objekti i Komunës);
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Certifikata e biznesit ose numri identifikues i fermerit NIF;
4. Të përshkruhet veprimtaria e biznesit që ushtrohet nga aplikuesi , dhe të ceken llojet e produkteve për plasim;
5. Dëshmi për pagesën e obligimeve Komunale;
-Vërtetimin e taksave komunale për bizneset

Përparësi në përfitimin e tezgave do të kenë:

1. Gratë mbajtëse të familjes;
2. Prodhuesit që janë apo kanë familjarë me nevoja te veçanta;

Sqarim : Dhënia e tezgave në shfrytëzim do të bëhet pa pagesë, si masë lehtësuese e Komunës për prodhuesit vendorë, ndërsa vendi i vendosjes së tezgës bëhet sipas rregullores komunale, në koordinim me DSHPAI-në;

Tezga jepet për shfrytëzim në periudhë kohore prej 6 muaj (me mundësi vazhdimi për kohëzgjatjen e përdorimit të tezgës)

Me mbylljen e vitit kalendarik, përfituesit duhet të paraqiten në zyrën e Zhvillimit Ekonomik për mundësinë e vazhdimit të shfrytëzimit të tezgës .

Afati i aplikimit është nga data 13.06.2025 deri 30.06.2025;

Kërkesat e pa kompletuara dhe ato që vijnë pas afatit, nuk do të merren parasysh;

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet të QSHQ, kati i I (parë)- *objekti* i Komunës;

Drejtore e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë

